



ANALIZË E LIGJORE MBI RËNDËSINË E LEGJISLACIONIT PËR BARAZINË GJINORE NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Hyrje

Ky dokument është përgatitur nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGjSh), duke synuar të ofrojë një analizë të përmbledhur ligjore mbi rëndësinë e legjislacionit për barazinë gjinore në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), duke evidentuar lidhjen ndërmjet kuadrit kombëtar, *acquis-it* të BE-së, angazhimeve të Shqipërisë në procesin e negociatave dhe kërkesës për zbatim efektiv e të qëndrueshëm.

Qëllimi i analizës është të tregojë se përafrimi i legjislacionit për barazinë gjinore me standardet e BE-së nuk përbën vetëm një kërkesë formale të procesit të anëtarësimit. Ai është pjesë e përgatitjes së Shqipërisë për të funksionuar si një shtet i ardhshëm anëtar, çka kërkon jo vetëm harmonizim ligjor, por edhe institucione funksionale, kapacitete administrative, mekanizma efektivë të zbatimit dhe rezultate të qëndrueshme. Në këtë kuptim, analiza e vendos ligjin nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” në një perspektivë më të gjerë: si pjesë e përafrimit me standardet evropiane, por edhe si instrument që duhet të mbështesë gatishmërinë juridike dhe institucionale të Shqipërisë gjatë dhe pas procesit të anëtarësimit.

Barazia ndërmjet grave dhe burrave përbën një nga vlerat themelore mbi të cilat mbështetet BE dhe një parim që shtrihet horizontalisht në fusha të ndryshme të *acquis-it*. Neni 2 i Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) e përfshin barazinë ndër vlerat themelore të Unionit, ndërsa Karta e të Drejtave Themelore ndalon diskriminimin dhe njeh shprehimisht barazinë ndërmjet grave dhe burrave¹.

Në këtë kuadër, barazia gjinore nuk lidhet vetëm me ndalimin e diskriminimit. Legjislacioni dhe politikat e Bashkimit Evropian e zhvillojnë këtë parim në fusha të tilla si punësimi dhe profesioni, paga e barabartë, mbrojtja sociale, vetëpunësimi, akses në mallra dhe shërbime, balanca ndërmjet jetës profesionale dhe familjare, pjesëmarrja në vendimmarrje dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore.

Për Shqipërinë, rëndësia e këtij kuadri duhet parë në kontekstin më të gjerë të procesit të integrimit evropian. Integrimi nuk kufizohet në përafrimin teknik të legjislacionit kombëtar me *acquis-in*, por kërkon që vendi kandidat të jetë në gjendje t'i zbatojë standardet e BE dhe të marrë përsipër në

¹ Shih: Traktati për Bashkimin Evropian, versioni i konsoliduar, neni 2; Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, nenet 20, 21 dhe 23



mënyrë të qëndrueshme detyrimet që burojnë nga anëtarësimi. Pikërisht në këtë perspektivë duhet parë edhe miratimi i ligjit nr. 64/2025. Ligji zëvendësoi kuadrin e vitit 2008 në një periudhë kur legjislacioni shqiptar, standardet ndërkombëtare dhe *acquis*-i i BE-së kishin evoluar ndjeshëm, duke krijuar nevojën për një kuadër horizontal më të përditësuar dhe më funksional.

1. Barazia gjinore si pjesë e standardeve të Bashkimit Evropian dhe e procesit të integritimit

Barazia ndërmjet grave dhe burrave është pjesë e vetë arkitekturës juridike të BE. Përveç parimeve të parashikuara në traktate dhe në Kartën e të Drejtave Themelore, *acquis*-i në këtë fushë është zhvilluar gradualisht dhe sot mbulon një gamë të gjerë marrëdhëniesh juridike, ekonomike dhe sociale.

Ndër aktet kryesore përfshihen Direktiva 2006/54/KE për zbatimin e parimit të mundësive dhe trajtimit të barabartë të grave dhe burrave në punësim dhe profesion, Direktiva 2004/113/KE për trajtimin e barabartë në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, Direktiva 79/7/KEE për trajtimin e barabartë në sigurimet shoqërore dhe Direktiva 2010/41/BE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet grave dhe burrave të angazhuar në veprimtari të vetëpunësuar. Në vitet e fundit ky kuadër është zhvilluar më tej. Direktiva (BE) 2019/1158 trajton balancën ndërmjet jetës profesionale dhe familjare për prindërit dhe kujdestarët; Direktiva (BE) 2022/2381 synon përmirësimin e balancës gjinore ndërmjet drejtorëve të shoqërive të listuara; Direktiva (BE) 2023/970 forcon zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të njëjtë ose me vlerë të barabartë përmes transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit; ndërsa Direktiva (BE) 2024/1385 krijon standarde të përbashkëta për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Zhvillimi i *acquis*-it tregon se qasja evropiane ka kaluar gradualisht nga një fokus kryesisht te ndalimi i diskriminimit drejt një qasjeje më të gjerë, që përfshin edhe parandalimin e pabarazive, eliminimin e barrierave strukturore, transparencën, mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave, integrimin gjinor në politikëbërje dhe forcimin e mekanizmave institucionalë dhe të monitorimit. Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020–2025 e konsolidoi këtë qasje, duke e lidhur barazinë gjinore me pjesëmarrjen ekonomike, hendekun gjinor në paga dhe pensione, përgjegjësitë e kujdesit, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore².

Ky orientim është zhvilluar më tej me Strategjinë e re të BE për Barazinë Gjinore 2026–2030, miratuar nga Komisioni Evropian në Mars 2026. Strategjia e re e vendos barazinë gjinore në lidhje

² Shih Komisioni Evropian, “A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020–2025” (Një Bashkim i Barazisë: Strategjia për Barazinë Gjinore 2020–2025), COM(2020) 152 final, Bruksel, 5.3.2020



me objektivat më të gjera strategjike të Bashkimit, përfshirë demokracinë dhe shtetin e së drejtës, kohezionin social, sigurinë dhe konkurrueshmërinë. Ajo vijon qasjen e integritimit gjinor në të gjitha politikatat, të kombinuar me masa të posaçme, dhe i kushton vëmendje pavarësisë ekonomike, hendekut gjinor në paga dhe pensione, përgjegjësi të kujdesit, pjesëmarrjes në vendimmarrje, dhunës me bazë gjinore dhe dimensioneve të reja që lidhen me zhvillimin digjital dhe teknologjik³.

Për Shqipërinë, kjo dinamikë është e rëndësishme sepse tregon se përafrimi nuk mund të jetë një proces statik. Një vend kandidat nuk duhet vetëm të transpozojë *acquis*-in që ekziston në një moment të caktuar, por të ndërtojë një sistem juridik dhe institucional të aftë të ndjekë dhe të përthithë zhvillimet e tij të vazhdueshme.

Lidhja ndërmjet barazisë gjinore dhe procesit të integritimit është reflektuar gjithashtu në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Në kuadër të bashkëpunimit social, neni 99 parashikon bashkëpunimin për përshtatjen e legjislacionit shqiptar lidhur me kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta për gratë, duke marrë si referencë nivelin e mbrojtjes në Bashkimin Evropian⁴.

Ndërkohë në terma të metodologjisë së zgjerimit, barazia gjinore lidhet drejtpërdrejt me Grupkapitullin 1 “Themeloret”, Kapitulli 23, në shtyllën e të drejtave themelore, Sa i përket rëndësisë, metodologjia i jep Grupkapitullit “Themeloret” rol qendror në procesin negociues. Aktualisht, Shqipëria është në fazën që ka përmbushur piketat e ndërmjetme të BE për këtë Grupkapitull dhe miratimi i ligjit nr.64.2025 ishte një nga arritjet e listuara në këtë proces. Kjo do të thotë se nga momenti i miratimit, vëmendja e BE është zhvendosur gjithnjë e më shumë drejt zbatimit të ligjit dhe rezultateve të matshme në drejtim të arritje efektive të barazisë midis grave dhe burrave në fushat e mbrojtura nga ligji.⁵ Për rrjedhojë, progresi i vendit në fushën e barazisë gjinore nuk është një kërkesë e krijuar vetëm nga faza aktuale e negociatave, por pjesë e orientimit afatgjatë të Shqipërisë drejt sistemit juridik dhe social të Bashkimit Evropian.

2. Ligji nr. 64/2025 si pjesë e angazhimeve të Shqipërisë për integrimin evropian

Rishikimi i ligjit për barazinë gjinore nuk ishte një zhvillim i shkëputur nga agenda kombëtare e zhvillimit dhe integritimit evropian. Nevoja për përditësimin e kuadrit ishte identifikuar gradualisht në dokumentet strategjike dhe të integritimit të Shqipërisë.

³ Shih Komisioni Evropian, *Gender Equality Strategy 2026–2030 (Strategjia për Barazinë gjinore 2026-2030)*, COM(2026) 113 final, Bruksel, 5.3.2026; SWD(2026) 82 final.

⁴ Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, neni 99 “Bashkëpunimi social”, OJ L 107, 28.4.2009

⁵ Shih, Komisioni Evropian, *Enlargement: Albania meets interim benchmarks for fundamentals cluster* (Zgjerimi: Shqipëria përmbush piketat e ndërmjetme për Grupkapitullin Themeloret), 26 Maj 2026.



Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, miratuar me VKM nr. 88, datë 22.2.2023, e trajton barazinë gjinore në kuadër të politikave për përfshirjen sociale. Dokumenti evidenton progresin e arritur në përfaqësimin e grave në jetën politike dhe vendimmarrje, përfshirë ndikimin e kuotave gjinore, por njëkohësisht evidenton problematika të vazhdueshme, si hendeku gjinor në paga. Në këtë kuadër, integrimi gjinor përcaktohet si një instrument për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri⁶.

Lidhja ndërmjet rishikimit të ligjit dhe procesit të integritit bëhet edhe më e drejtpërdrejtë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, miratuar me VKM nr. 16, datë 11.1.2024. PKIE parashikonte ndër masat për vitin 2025 miratimin e projektligjit për barazinë gjinore në kuadër të Grupkapitullit 1 “Themeloret” dhe e lidhte këtë masë me harmonizimin me Strategjinë e Barazisë Gjinore të BE-së 2020–2025. Një rëndësi të veçantë ka Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM nr. 736, datë 13.12.2023, në kuadër të piketave hapëse të Grupkapitullit “Themeloret”, ku përfshihet angazhimi i shtetit shqiptar për sigurimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe garantimin e barazisë gjinore dhe të drejtat e grave, përveç të tjerave përmes përditësimit të legjislacionit për barazinë gjinore⁷.

Së fundmi, nevoja për zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit mbështetëj edhe nga vlerësimet e KE në kuadër të monitorimit vjetor. Konkretisht, në Raportin për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian vlerësoi se kuadri ligjor dhe institucional për barazinë gjinore ishte pjesërisht i përafëruar me *acquis*-in e BE-së dhe standardet evropiane⁸.

Të gjitha këto instrumenta tregojnë se nevoja për rishikimin e legjislacionit për barazinë gjinore ishte identifikuar qartë përpara miratimit të ligjit nr. 64/2025 dhe ishte integruar në dokumentet kryesore të zhvillimit dhe të integritit evropian të Shqipërisë. Për rrjedhojë, ligji i ri duhet parë si pjesë e përbushjes së një angazhimi të vazhdueshëm për përafrimin e kuadrit kombëtar me *acquis*-in dhe standardet e BE dhe për forcimin e bazës ligjore e institucionale të nevojshme për zbatimin efektiv të barazisë gjinore.

3. Nga harmonizimi të gatishmëria për anëtarësim

Siç e theksuam që në hyrje të kësaj analize, harmonizimi i legjislacionit me *acquis*-in është një pjesë thelbësore e procesit të integritit, por nuk përbën qëllimin përfundimtar të tij. Anëtarësimi

⁶ Shih, Këshilli i Ministrave, Vendim nr. 88, datë 22.2.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”.

⁷ Shih, Këshilli i Ministrave, Vendim nr. 736, datë 13.12.2023, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”, pikat III.A dhe III.K.

⁸ Shih, Komisioni Evropian, Raporti i Progresit, Viti 2024, SWD(2024) 690 final, Bruksel, 30.10.2024, seksioni mbi barazinë gjinore.



kërkon që Shqipëria të jetë në gjendje t'i zbatojë realisht detyrimet që merr përsipër dhe të vazhdojë t'i zbatojë ato edhe pasi procesi i negociatave të ketë përfunduar. Për këtë arsye, procesi i integritetit duhet të prodhojë jo vetëm përputhshmëri ligjore, por edhe gatishmëri për anëtarësim. Kjo nënkupton që kuadri juridik, institucionet dhe administrata të jenë të afta të funksionojnë sipas standardeve të BE-së pa qenë të varura nga dinamika e negociatave apo nga presioni i monitorimit të jashtëm.

Në fushën e barazisë gjinore, kjo gatishmëri ka disa dimensione të ndërlidhura:

Së pari, kërkon një kuadër normativ të aftë jo vetëm të reflektojë *acquis*-in ekzistues, por edhe të përshtatet me zhvillimet e ardhshme. Direktivat e miratuara gjatë viteve të fundit për balancën punë–jetë, transparencën e pagave, përfaqësimin në bordet e shoqërive të listuara dhe luftën kundër dhunës ndaj grave tregojnë se kuadri evropian vazhdon të evoluojë. Për rrjedhojë, harmonizimi duhet kuptuar si proces dinamik dhe jo si një ushtrim i vetëm legjislativ.

Së dyti, gatishmëria kërkon kapacitete institucionale dhe administrative. Institucionet duhet të kenë kompetencat, strukturat, burimet njerëzore dhe procedurat e nevojshme për të zbatuar standardet, për të mbledhur dhe analizuar të dhëna, për të vlerësuar ndikimin e politikave dhe për të monitoruar rezultatet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një fushë horizontale si barazia gjinore, ku zbatimi nuk mund të jetë përgjegjësi vetëm e një institucioni, por kërkon përfshirjen e një numri të gjerë strukturash qendrore dhe vendore.

Së treti, nevojitet rritja e proaktivitetit për zbatimin e masave dhe rritjen e llogaridhënies. Ekzistenca e një ligji të përafëruar nuk është e mjaftueshme nëse nuk mund të demonstron se ai funksionon.

Për këtë arsye, në fazat më të avancuara të integritetit rëndësi gjithnjë e më të madhe marrin mekanizmat e monitorimit, të dhënat e besueshme dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të gjurmimit të rezultateve. Faza aktuale e negociatave të Shqipërisë e bën këtë veçanërisht të rëndësishme. Përmbushja e piketave të ndërmjetme të Grupkapitullit “Themeloret” nuk nënkupton përfundimin e reformave në këtë fushë, por kalimin në një fazë ku zbatimi, qëndrueshmëria e rezultateve dhe aftësia e institucioneve për të ruajtur standardet marrin një peshë edhe më të madhe. Në këtë fazë, pyetja kryesore nuk është më vetëm “a është miratuar ligji?”, por “si po zbatohet ligji dhe çfarë rezultatesh po prodhon?”.

Ky dimension bëhet edhe më i qartë kur integriteti shihet përtej momentit të anëtarësimit. Pas hyrjes në Bashkimin Evropian, Shqipëria nuk do të jetë më vetëm një vend që përafron legjislationin e tij me standarde të hartuara në nivel të BE-së. Ajo do të jetë pjesë e sistemit ku këto rregulla zbatohen, monitorohen dhe zhvillohen më tej. Për rrjedhojë, institucionet shqiptare duhet të jenë të afta të zbatojnë *acquis*-in në mënyrë të vazhdueshme, të reagojnë ndaj zhvillimeve të reja dhe të marrin pjesë në proceset evropiane të vendimmarrjes.



Në këtë kuptim, harmonizimi i legjislacionit sot duhet të shihet si pjesë e ndërtimit të aftësisë së Shqipërisë për të funksionuar si shtet anëtar nesër.

Përfundime

Legjislacioni për barazinë gjinore ka rëndësi të drejtpërdrejtë për procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ligji nr. 64/2025 duhet parë në këtë kontekst si pjesë e përditësimit të kuadrit horizontal të barazisë gjinore dhe e përgatitjes së Shqipërisë për një fazë më të avancuar të integritit. Në momentin e anëtarësimit, Shqipëria duhet të jetë jo vetëm juridikisht e përafuar, por edhe institucionalisht e aftë të zbatojë *acquis*-in, të monitorojë rezultatet, të përshtatet me zhvillimet e tij të ardhshme dhe të marrë pjesë në proceset evropiane të vendimmarrjes. Për këtë arsye, gatishmëria për anëtarësim duhet kuptuar si kombinim i harmonizimit ligjor, kapaciteteve institucionale dhe rezultateve të qëndrueshme të zbatimit. Për legjislacionin e barazisë gjinore, kjo do të thotë që parimet e barazisë të mos mbeten vetëm pjesë e tekstit ligjor, por të reflektohen në mënyrën se si hartohen politikat, përdoren burimet publike, funksionojnë institucionet, mbledhen dhe përdoren të dhënat dhe vlerësohen rezultatet.

Në këtë kuadër, QDGjSh vlerëson se faza pas miratimit të ligjit nr. 64/2025 duhet të orientohet veçanërisht drejt këtyre prioritetëve:

- Zbatimi efektiv i mekanizmave të parashikuar nga ligji dhe monitorimi i rezultateve. Vlerësimi i ndikimit gjinor, buxheti i përgjigjshëm gjinor, mekanizmat e koordinimit institucional dhe instrumentet e monitorimit duhet të kthehen në praktika të qëndrueshme të administratës. Në të njëjtën kohë, prodhimi dhe përdorimi sistematik i të dhënave të ndara sipas gjinisë duhet të shërbejë jo vetëm për raportim, por edhe për identifikimin e pabarazive, hartimin e politikave dhe vlerësimin e rezultateve të tyre.
- Vijimi i përafrimit të legjislacionit sektorial me *acquis*-in e BE-së. Natyra horizontale e ligjit nr. 64/2025 nuk zëvendëson nevojën për të vlerësuar dhe plotësuar përputhshmërinë e Kodit të Punës, legjislacionit për sigurimet shoqërore dhe mbrojtjen sociale, vetëpunësimin, balancën ndërmjet jetës profesionale dhe familjare, pagën e barabartë, aksesin në mallra dhe shërbime dhe fushave të tjera relevante me zhvillimet më të fundit të *acquis*-it. Ky proces duhet të jetë i vazhdueshëm, veçanërisht në kushtet kur standardet evropiane në fushën e barazisë gjinore vijnë të zhvillohen.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e Bashkimit Evropian dhe me shtetet anëtare. Bashkëpunimi me Komisionin Evropian dhe Institutin Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) mund të mbështesë harmonizimin e metodologjive, zhvillimin e statistikave dhe treguesve të krahasueshëm, përdorimin e instrumenteve të integritit gjinor dhe



monitorimin e progresit. Po kështu, shkëmbimi i përvojave me institucionet homologe të shteteve anëtare mund të kontribuojë në forcimin e strukturave kombëtare, mekanizmave të koordinimit dhe praktikave të zbatimit.

- Ndjekja sistematike e jurisprndencës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. Interpretimi i GJED-së për çështje të tilla si diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, paga e barabartë, barra e provës, trajtimi i barabartë dhe masat pozitive është pjesë e rëndësishme e mënyrës se si *acquis*-i zbatohet në praktikë. Për rrjedhojë, këto standarde duhet të reflektohen gjithnjë e më shumë në analizën ligjore, trajnimin profesional dhe praktikën administrative dhe gjyqësore shqiptare.
- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe aktorëve që punojnë në fushën e barazisë gjinore. Zbatimi i kuadrit të ri kërkon njohuri të qëndrueshme dhe të përditësuara mbi legjislacionin kombëtar, *acquis*-in, jurisprndencën evropiane, instrumentet e integritit gjinor dhe metodologjitë e monitorimit. Në këtë drejtim, duhet të nxitet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse për barazinë gjinore, institucioneve të tjera publike, organizatave të shoqërisë civile, akademisë dhe profesionistëve të fushës për zhvillimin e trajnimeve, shkëmbimin e ekspertizës, përgatitjen e materialeve praktike dhe krijimin e komuniteteve profesionale që mbështesin zbatimin e qëndrueshëm të standardeve të barazisë.

Sa më sipër, vlen të konkludohet se rëndësia afatgjatë e ligjit nr. 64/2025 në procesin e integritit nuk qëndron vetëm në faktin se ai përmbush një angazhim të parashikuar në dokumentet e negociatave. Ajo qëndron në kontributin që ky ligj mund të japë për kalimin e Shqipërisë nga përafrimi formal drejt një sistemi të plotë dhe të qëndrueshëm të zbatimit të barazisë gjinore, të mbështetur në legjislacion sektorial të përafruar, institucione funksionale, të dhëna dhe monitorim të besueshëm, bashkëpunim të strukturuar me mekanizmat e BE-së dhe zbatim të standardeve të zhvilluara nga jurisprudenca evropiane. Vetëm në këtë mënyrë kuadri i ri mund të shërbejë njëkohësisht si instrument për avancimin e barazisë gjinore në vend dhe si pjesë funksionale e përgatitjes së Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.



Burimet e analizës

A. Kuadri kombëtar

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”, veçanërisht pikat III.A dhe III.K.

B. Kuadri i Bashkimit Evropian dhe dokumentet e KE

- Traktati për Bashkimin Evropian, versioni i konsoliduar, veçanërisht neni 2.
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, veçanërisht nenet 20, 21 dhe 23.
- Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, veçanërisht neni 99 “Bashkëpunimi social”.
- Komisioni Evropian, *Raporti për Shqipërinë 2024*, SWD(2024) 690 final, Bruksel, 30.10.2024.
- Komisioni Evropian, *Një Bashkim i Barazisë: Strategjia për Barazinë Gjinore 2020–2025*, COM(2020) 152 final, Bruksel, 5.3.2020.
- Komisioni Evropian, *Strategjia për Barazinë Gjinore 2026–2030*, COM(2026) 113 final, Bruksel, 5.3.2026.
- Komisioni Evropian, SWD(2026) 82 final, dokumenti shoqërues i *Strategjisë për Barazinë Gjinore 2026–2030*.
- Komisioni Evropian, *Zgjerimi: Shqipëria përmbush piketat e ndërmjetme për Grupkapitullin “Themeloret”*, 26 maj 2026.



C. Acquis-i kryesor i BE-së për barazinë gjinore

- Direktiva 2006/54/KE për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të grave dhe burrave në çështjet e punësimit dhe profesionit.
- Direktiva 2004/113/KE e Këshillit për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet grave dhe burrave në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime.
- Direktiva 79/7/KEE e Këshillit për zbatimin gradual të parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet grave dhe burrave në çështjet e sigurimeve shoqërore.
- Direktiva 2010/41/BE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet grave dhe burrave që ushtrojnë veprimtari të vetëpunësuar.
- Direktiva 92/85/KEE e Këshillit për masat që synojnë përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjëseve shtatzëna, atyre që kanë lindur së fundmi ose që ushqejnë me gji.
- Direktiva (BE) 2019/1158 për balancën ndërmjet jetës profesionale dhe familjare për prindërit dhe kujdestarët.
- Direktiva (BE) 2022/2381 për përmirësimin e balancës gjinore ndërmjet administratorëve të shoqërive të listuara.
- Direktiva (BE) 2023/970 për forcimin e zbatimit të parimit të pagës së barabartë për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, përmes transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit.
- Direktiva (BE) 2024/1385 për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.